

BRAMAC

Udhëzime për mirëmbajtjen e çatisë **BMI Bramac**



Part of **BMI**

bmigroup.com/al

Kujdesuni për çatinë tuaj - në mënyrë të sigurt, të përsosur dhe profesionale

Për të siguruar gjendjen perfekte të çatisë tuaj dhe jetëgjatësinë e saj, është e nevojshme ta inspektoni atë. Pavarësisht nëse bëhet fjalë për çati të pjerrët apo të rrafshët, kushtet ekstreme të motit - stuhitë, erërat e forta, shirat e rrëmbyer, breshëri dhe bora, si dhe nxehtësia ekstreme dhe thatësira; nuk kursejnë as njërin e as tjetrën. Prandaj, ju këshillojmë që të inspektoni çatinë tuaj të paktën një herë, dhe mundësisht dy herë në vit, në pranverë dhe në vjeshtë. Inspektimi duhet të bëhet nga një specialist i kualifikuar - çatipunues.

E siguruar mirë - kundër ndryshimeve klimatike dhe ekstremeve të motit

Çatitë jo vetëm që preken nga dëmtimet përgjatë kohës, ato gjithashtu duhet të përballojnë të gjitha forcat e natyrës. Me ndryshimin e klimës, moti ekstrem është bërë i përhershëm dhe kërcënon gjithnjë e më shumë çatitë tona. Kjo është arsyeja pse inspektimet e rregullta janë thelbësore për të larguar ose korrigjuar çdo parregullsi.

Kushtojini vëmendje të veçantë:

- Dëmtimit të çatisë (çarje, vrima)
- Përkuljeve të mundshme, lëvizjes së çatisë
- Fiksimit të elementeve borëmbajtës ose sistemit borëmbajtës
- Kontrollit nëse uji rrjedh lirisht nga çatia - ulluqet e bllokuara
- Izolimit korrekt të bashkimeve në çati (sete aspirimi, dritare) dhe pjesës rreth oxhakut
- Zonat ku mund të shfaqet një sipërfaqe më e madhe myshku

Edhe një dëmtim i vogël në çatinë tuaj, gjatë një stuhie mund të shkaktojë më shumë dëme në planin afatgjatë. Edhe një devijim i vogël i tjegullës mund të bëhet një "pikë sulmi" për efektin absorbues të erës gjatë stuhisë së ardhshme, e cila mund të çojë në zbulimin e pjesës më të madhe të çatisë. Një çarje e vogël në çati mund të plasarit më tej nga akulli dhe bora dhe të shkaktojë dëme të konsiderueshme.

Vëzhgoni masat e sigurisë dhe zëvendësoni menjëherë parregullsitë e vogla

Heqja rregullisht e gjetheve në ulluqe dhe tubat e shkarkimit është gjithashtu thelbësore. Për sa kohë që ulluqet janë të zëna, rrjedhja e ujit është e pamundur. Kur temperaturat bien nën zero, ky ujë ngrin dhe mund të shkaktojë plasje të ulluqeve dhe tubave. Kjo mund të shmanget duke hequr rregullisht gjethet. Është gjithashtu e rëndësishme të pastroni buzën e çatisë – rrjetat e zogjve.

Parregullsitë e vogla, nëse zbulohen në kohë, zakonisht nuk janë shkak për probleme të mëdha, pasi ato mund të riparohen dhe zgjidhen shpejt. Prandaj, një çati e mirëmbajtur ka një jetëgjatësi shumë më të gjatë. Në të njëjtën kohë, siguron që struktura e poshtme e çatisë të mos dëmtohet, gjë që e bën vetë ndërtesën të sigurt dhe jetëgjatë.

Masa më e mirë paraprake – Materiale mbulimi BMI Bramac

Masa më e mirë paraprake që mund të merrni kur ndërtoni ose rinovoni çatinë është të zgjidhni materialin e duhur të mbulimit të çatisë. Disa çati humbasin qëndrueshmërinë e tyre me kalimin e viteve, por tjegullat e betonit BMI Bramac me kalimin e kohës e rrisin qëndrueshmërinë e tyre dhe në këtë mënyrë ofrojnë mbrojtje maksimale ndaj ngarkesave nga bora, akulli dhe breshëri. Në rast dëmtimi, tjegullat BMI Bramac mund të zëvendësohen lehtësisht dhe pa asnjë problem. Një avantazh shtesë është se ka komponentë universalë origjinalë të disponueshëm për çdo model tjegulle (betoni ose qeramike). Nga setet e aspirimit, sistemi borëmbajtës, elementët borëmbajtës, bashkimet e sigurta për hyrjen në çati. Mund të merrni gjithçka që ju nevojitet për një çati të sigurt në një adresë të vetme.

Për çdo pyetje shtesë në lidhje me shtrimin e tjegullave ose udhëzimet e mirëmbajtjes, jemi në dispozicionin tuaj në numrin e telefonit: +355 4 222 6397 ose adresën e-mail-it: info_al@bmgigroup.com